COLLOQUIUM

Revistë Studentore nr.4

JETA E VËSHTIRË E FAMILJES SMAKAJ NGA SKËNDERAJ

QENTË ENDACAKË PROBLEM I VAZHDUESHËM PËR QYTETARËT

MITROVICA, QYTETI ME SEMAFORË JASHTË FUNKSIONIT

FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE MBETET PROBLEM NË KOSOVË

FESTË E MADHE ARTISTIKE, NDËRKOMBËTARE NË KOLEGJIN AAB

PROFESIONET E PAZAKONSHME PËR FEMRAT NË MENDËSINË TONË

Editorial

Colloquium - Punë e studentëve

Arta Berisha *(asistente në lëndën Praktikë Zhanret e Gazetarisë*

Revista "Colloqium" e vitit 2019 përmbanë artikuj gazetarie të shkruar nga studentët e vitit të dytë të Fakultetit të Gazetarisë në Kolegjin AAB. Bëhet fjalë për produkte të përfunduara në kuadër të lëndës Praktikë - Zhanret e Gazetarisë. Edhe këtë vit studentët, duke u bazuar në detyrimet e plan programit mësimor, kanë praktikuar zhanret e gazetarisë. Lajmi, raporti, reportazhi, intervista janë materiale për të cilat studentët janë angazhuar jo thjeshtë si student por duke hyrë edhe në rolin e gazetarëve të mirëfillt. Puna e tyre ka konsistuar në grumbullimin e materialit të nevojshëm nga burime zyrtare dhe jo zyrtare në terren. Studentët gjithashtu kanë shfrytëzuar internetin dhe platformat online për informacione shtesë. Edhe këtë vit, revista përmbanë tregime që prekin shoqërinë dhe që janë në përputhje me aktualitetin në Kosovë. Politikanët dhe politika ditore është lashtë fokusit. Temat që do të mund t'i lexoni në këtë numër flasin për mungesën e semaforëve në Mitrovicë, sfidat e grave në punësim, rrezikun nga qentë endacakë etj. Studentët e apasionuar pas fotografisë kanë gjetur fotoraportazhin si mënyrën e duhur për ta ilustruar fenomenin e papunësisë dhe atë të varfërisë në Kosovë. Është pra, kjo një punë, e nisur dhe e përfunduar nga vetë studentët. Ndërhyrjet e vetme janë në ndonjë lëshim të vogël drejtshkrimor, por jo edhe në strukturë dhe përmbajtje të artikujve. Në një kohë kur mungesa e profesionalizmit rrezikon të shndërrohet në normë për shkak të vërshimit të portaleve, ky numër tregon për dëshirën dhe gazetarëve të rinj që të jenë në anën e duhur; duke i respektuar parimet themelore të gazetarisë.

Revistë e studentëve të Fakultetit të Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë të Kolegjit AAB

COLLOQUIUM Nr. 4, 2019

Boton: Kolegji AAB
Redaktoi: Arta Berisha
Lektura: Lindita Dinosha
Layout: Lirigëzon Selimi

Zona Industriale Prishtinë - Fushë Kosovë
10000 Prishtinë
Tel: 038 600 005,
email: revista@aab-edu.net

Profesionet e pazakonshme për femrat në mendësinë tonë

Vlora, Era dhe Donjeta

"Shume njerëz në fillimet e punës time më kanë paragjykuar vetëm se jam grua mirëpo unë asnjëherë nuk jam ndikuar prej tyre sepse e kam përkrahjen e plotë nga familja ime", thotë Vlora Veseli, 45- vjeçarja nga Gjilani që punon si taksiste.

Vlora Veseli, taksiste ne Gjilan

Është mesnatë, dritat e shtëpive janë të fikura, nëpër rrugët e qytetit të Gjilanit mbizotëron qetësia. Megjithatë për Vlora Veselin, e cila punon taksiste kjo nuk është shumë domethënese. Ajo, ulur në veturën e saj, po e pret udhëtarin e radhës. Nuk është profesion i zakonshëm për gratë në Kosovë por kjo nuk e pengon dyzet e pesë vjeçaren nga Gjilani që ta ushtroj punën si taksiste.

Këtë punë thotë se e ka filluar nga kurreshtja.

"Burri im punon taksist e një ditë kur dola të blejë gjëra për shtëpi, ai ka harrur ta largojë reklamën, hasa në pasagjer dhe nga kurreshtja i mora t`i dërgoj në destinacion", tha ajo.

E pas këtij rasti Vlora thotë se ka vazhduar të punojë si taksiste.

Paragjykimet për të kanë qenë të shumta mirëpo kjo nuk e ka penguar atë ta vazhdoj punën.

"Shume njerëz në fillimet e punës time më kanë paragjykuar vetëm se jam grua mirëpo unë asnjëherë nuk jam ndikuar prej tyre sepse e kam përkrahjen e plotë nga familja ime", shtoi ajo.

Vlora thekson se është e suksesshme në këtë punë, e pëlqyer nga klientët por edhe nga kolegët e saj të cilët janë meshkuj. Madje siç tregon vetë ajo, në fillimet e punës klientët kanë insistuar që të udhëtojnë vetëm me veturën e saj. Puna e një gruaje si taksiste ka bërë që shumë gra të udhëtojnë me taksi në drejtime të largëta por duke e kontraktuar fillimisht Vlora Veselin.

"Prej se Vlora punon taksiste gjithmonë kur kam për të shkuar ne destinacione të largëta e thërras atë kurse më herët e kam shmangur përdorimin e taksive", u shpreh një kliente.

Taksistja e parë grua në Gjilan e ka pasur fillimin e vështirë por kjo ka hapur rrugë për gra të tjera që të punojnë punë që ende konsiderohen të pazakonshme për to.

Në Kosovë, veçanërisht në komuna më të vogla si Gjilani është e pazakontë edhe puna e grave

si kamariere.
Ndryshe nga të gjitha kafiteritë e tjera në qytet, "Grande Calabria" ka punësuar njëzet e dy punëtore gra. Duke filluar nga kamarierja e deri tek menaxherja i gjithë stafi në këtë kafiteri përbëhet nga gratë. Ato janë shumë të kënaqura për punën që e bëjnë si dhe për respektin që gëzojnë nga klientet.

Kafiteri "Grande Calabria"

"Punoj që dy vite edhe më pëlqen shumë puna që e bëj, kurrë nuk kam pasur problem me klientë, përkundrazi edhe më shumë më respektojnë se jam femër", tha Era Hajdari, punonjëse në kafiteri.
Vetë klientët shprehen se janë të kënaqur me shërbimet që ofrohen duke e bërë këtë kafiteri një ndër më të frekuentuarat në qytet.
"Në fillim është dukur e çuditshme kur kemi parë vajza duke punuar kameriere po tash jemi mësuar, shumica vijnë e pijnë kafen e mëngjesit këtu", u shpreh një kliente. Mendimi që një grua nuk është e aftë të kryej ato që konsiderohen si "punët e burrave" e kufizon mundësinë e përfshirjës së grave në shoqëri. Këtë mendim e kundërshton edhe Donjeta Sejdiu, njëzet e tetë vjeçarja nga Gjilani. Ajo ka tre vite që punon si larëse e automjeteve. Këtë punë ajo e filloi rastësisht kur bashkëshorti i saj i kerkoi ta ndihmonte. "Kishte mungesë të stafit puna duhej të kryhej dhe unë e mora përsipër", tha ajo.
Perveç se punëtore është edhe amvise ku shumë lehtë po arrinë t`i menaxhoj të dyja.
"Kujdesem edhe për shtëpinë, në pushime të shkurtëra gjatë ditës, bëj bukën dhe punët e shtëpisë", shtoi Donjeta. Por, shumë herë paragjykimet ndaj saj nuk mungojnë . "Ka njerëz që më kanë thënë lëre ketë punë se nuk është për gra por për është për burra, mirëpo unë jam e kënaqur, jo vetëm që e bëjë për vete por ndihem mirë kur i ndihmoj bashkëshortit tim", u shpreh ajo.
Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës,



Donjeta Sejdiu, autolarje, TRINGA

shkalla e punësimit gjatë vitit 2018 ishte dukshëm më e lartë për meshkuj sesa për femra. Rreth 45.5% e meshkujve në moshë pune ishin të punësuar krahasuar me 11.8% të femrave po ashtu ne moshë pune. Sipas gazetës Blic që citon Rrjetin e grupit të grave, mbi 80 përqind e grave janë jo aktive në tregun e punës. Arsye kryesore për këtë gjendje konsiderohet se janë detyrimet familjare, kujdesi ndaj fëmijëve si dhe ndaj të moshuarve. Kjo organizatë konsideron që diskriminimi gjinor zvogëlohet në momentin që qeveria ndryshon ligjin e punës duke ofruar pushimin e atësisë edhe për burrat; një mënyrë kjo që gratë e punësuara të kthehen më herët në punë dhe të zvogëlohen gjasat e ndërprerjen së kontratës dhe ndalesës në ngritje në pozitë.

Bleona BERISHA dhe Albunita KADRIU

Radio Gjilani vazhdon sfidën konkurruese në epokën e internetit

Radio Gjilani, si media e parë dhe e vetme në rajonin e anamoravës, shënon 46-vjetorin e themelimit të saj. Konsiderohet simbol për qytetin dhe rajonin e tij.

Logo, "Radio Gjilani"

E ka filluar punën që në vitin 1973, por edhe sot e kësaj dite vazhdon punën duke ruajtur dëgjuesit besnikë. Fjala është për Radio Gjilanin, e cila sot ka 24 orë program dhe transmeton edhe në gjuhën serbe, turke dhe rome. Si të gjitha institucionet në Kosovë, edhe radio Gjilani përjetoi mbylljen nga pushteti okupues i Serbisë në vitin 1990. Stafi i radio gjilanit përbëhej nga gazetarë të zot ndërsa themeluesit e saj ishin: Nexhip Bejta, Sabit Zymberi, Ramadan Bislimi dhe Selman Vokshi. Radio Gjilani riktheu transmetimin e saj në vitin 1999, pas çlirimit të Kosovës.

Transmetim edhe online

Sot Radio punon në frekuencat tokësore 93.5FM, dëgjohet dhe në internet nëpërmjet webfaqes radiogjilani.net, duke dhënë programe pa ndërprerë 24 orë në ditë. Por pavarësisht se konsiderohet si simbol i komunës dhe rajonit, sot radio në përgjithësi balllafaqohet me sfida të mëdha. Zhvillimet teknologjike dhe interneti kanë bërë që njerëzit më shumë të informohen nga mediat online se sa të presin informacionet e fundit nga mediat tradicionale sic është edhe radio.

Nijazi Selimi, gazetar në Radio Gjilani thotë se puna në radio ka vështirësi sidomos në aspektin material edhe pse ka një angazhim te madh të puntorëve të vjeter dhe atyre të rinjëve. " Po mundohemi që ky zë dikur i fuqishëm të mos shuhet, se paku t'u mbetet gjeneratave të reja", tha ai.

Nijazi Selimi, gazetar

Gazetarja dhe moderatorja Kimete Ibrahimi drejton emisionin "Pasditja me Kikin" i cili trajton tema të ndryshme si dhe është i hapur për bashkëbisedim me qytetarë.

Kimete Ibrahimi, gazetare

"Punën që unë e bëjë nuk është e lehtë ta menagjosh nga dëgjuesit e shumtë rreth temave të ndryshme të njejten kohë dhe atraktive por që me pëlqen ta drejtoj emisionin tim në atë mënyrë që dëgjuesit të jenë të kënaqur ", thotë Ibrahimi. Më sfiduese puna në radio është të punosh si gazetare në terren. Kështu të paktën e përshkruan punën e saj Rajmonda Shkodra, gazetare e lajmeve në radio Gjilani. "Puna si gazetare tereni në shumicen e rasteve merret si tallje por që mua nuk më pengojnë fare dhe se e bëj me vullnet dhe entuziazëm të madh", thotë Rajmonda Shkodra.



KOMUNA E GJILANIT
OPSTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN

KRYETARI I KOMUNËS

NDAN

"MIRËNJOHJE KOLEKTIVE"

PËR

"RADIO GJILANI"

Për kontributin e vazhdueshëm të dhënë në informimin e drejtë të opinionit gjilanas.

Gjilan, 22 Nëntor 2018

LUTFI HAZIRI
KRYETAR I KOMUNËS

Si e kujtojnë radion e tyre qytetarët e Gjilanit?

Varësisht nga mosha, qytetarët kanë kujtime dhe mendime të ndryshme për Radio Gjilanin. Disa ndjejnë nostalgji, sikurse që ka të tjerë që nuk e vlerësojnë si mjet të domosdoshëm të informimit.

"U kanë koha kur gjithë ditën rrisha me radio gjilanin, kisha radion time në dhomë dhe lajmet i dëgjoja me kohe sikurse këngët i kisha për qejfin tim por edhe sot e dëgjoj radion" thotë Sejdi Selimi, i moshuar, nga Komuna e Gjilanit. Muharrem Ramadani, 46 vjeçar kujton kohën kur radio Gjilani riktheu transmetimin menjëherë pas luftës.



Sejdi Selimi, banor nga Gjilani

"Kishte lajme me orar dhe nuk mungonin asnjëherë, ne qëndronim afër radios që t'i dëgjonim ato, kishte muzikë gjatë gjithë kohës, 24 orë, ishte një knaqësi për ne pasi filluam të informoheshim përsëri me ngjarje të reja që ndodhnin në Gjilan", thotë Muharrem Ramadani. Por ndryshe nga vite më parë, sot Radio Gjilani nuk e ka dëgjueshmërinë që e ka pasur. Të rinjt thonë se e dëgjojnë radion në veturë apo në dyqane të ndryshme por nuk kanë një radio në shtëpitë e tyre. "E dëgjoj radio Gjilanin kur kam kohë dhe në kohën kur është programi "Pasdite me Kikin" për shkak se ka tema interesante dhe ka lojëra shpërblyese", thotë Vlera, 18 vjecare nga Gjilani.

Erza LIMANI

Furnizimi me energji elektrike mbetet problem në Kosovë

Autoritetet arsyetojnë mungesën e rrymës me argumentin se në zona të caktuara po investohet në vendosjen e rrjetit të ri.

Foto e huazuar nga "Kosova Press"

Edhe pse kanë kaluar disa vite nga privatizimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, qytetarët e Kosovës ende ballafaqohen me reduktime të energjisë elektrike. Por tashmë Kompania private për shpërndarjen e energjisë KEDS ka hequr nga përdorimi termin reduktime. E ka zëvendësuar atë me ndërprerje të planifikuara pasi arsyetimi që jepet kur qytetarët mbesin pa drita është se po bëhen investime në rrjetin e shpërndarjes.

Banoret e lagjes "Kodra e Trimave" në Prishtinë ballafaqohen me mungesë të energjisë elektrike në baza ditore. Problemet janë bërë më të mëdha në sezonën e dimrit kur reduktimet e rrymës janë bërë më të ashpra. Banorët tregojnë se shumica prej tyre si burim për ngrohje e shfrytëzojnë energjinë elektrike. Zëdhënësi i KEDS-it Viktor Buzhala ka arsyetuar reduktimet me energji elektrike ne lagjen "Kodra e Trimave" me argumentin se për shkak të vjetërsisë së rrjetit ndodhin kycje ilegale të cilat e mbingarkojnë sistemin.

"Në 'Kodren e Trimave' ngjashëm me shumicën e vendeve në Kosovë është një rrjet shumë i vjetër, sikurse edhe trafo stacionet janë të vjetra. Ne e kemi në plan të investojmë 5 milionë euro në këtë pjesë, por fatkeqësisht Komuna e Prishtinës nuk na ka dhënë lejen për asnjë projekt deri më tash. Ky investim nënkupton vendosjen e rrjetit të ri dhe evitimin e prishjeve në rrjet, të cilat aktualisht po ndodhin si pasojë e kyçjeve ilegale dhe të mbingarkesave", ka thënë Buzhala.

Banorët tregojnë se reduktimet janë shumë të ashpëra; në disa raste vetëm 4-5 orë gjatë ditës ata thonë se kanë rrymë.

"E tmerrshme, gati gjithë ditën rrymë kemi vetëm 4-5 orë, nuk po mundemi me mbrri as ushqim me pergatitë tash dimri edhe terr po

bëhet shumë herët veç gjeneratorët që po na mundësojnë nganjëherë të kemi drita pak ëa gjatë sepse ne të kundërtën vetëm me qirinj po kemi dritë", thotë Rina Hyseni, banore në lagjen Kodra e Trimave në kryeqytet.

"Të gjitha rrugët janë pa drita, rryma po ndalet pikërisht kur bie terri edhe fmijët në shkollë duhet të shkojë t'i marrim sepse frikësohen të kthehen në shtëpi kur rrugëve nuk ka fare drita. Kjo është shume keq, sidomos për neve që jemi më të moshuar", tregon Idriz Rexhepi, një banor tjetër i kësaj lagjeje.

Nga ana tjetër, zyrtarë të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) thonë se sipas planit të prodhimit KEK-u është duke operuar me kapacitete të plota, pra janë në funksion të prodhimit dy blloqet e termocentralit "Kosova B" dhe dy blloqet e termocentralit "Kosova A", të cilat kanë kapacitete prodhuese rreth 750 megavate orë energji elektrike.

Lagjja Kodra e Trimave, www.prishtinapress.eu

Termocentralet e Korporatës Energjetike të Kosovës

"Aktualisht jemi në dispozicion të prodhimit të energjisë elektrike me 100% të kapaciteteve nga ato të planifikuara. Në këtë drejtim, KEK-u duke respektuar plotësisht obligimet në kontratë, si dhe rregullat e tregut në fuqi, me kohë, njofton operatorët për planin e prodhimit një ditë më herët. Prandaj, ashtu siç ka qenë kërkesa me operatorë, pra sipas planit të prodhimit edhe dje i jemi përmbajtur atij plani të prodhimit. Për më tepër, gjendja e prodhimit të energjisë elektrike nga ana e KEK-ut është stabile dhe pa ndryshime edhe për ditët në vijim, në rrethana të kushteve operative dhe klimatike. Ndërsa përgjegjësinë ekskluzive për furnizim të qytetarëve me energji elektrike sipas licencës nga ZRRE-ja e ka KEDS/KESCO-s si furnizuesi publik, i cili ka obligim të menaxhojë energjinë në dispozicion nga vendi dhe jashtë dhe të mos lërë konsumatorët pa energji", ka thënë Skender Bucolli nga Korporata Energjetike e Kosovës.

Lagjja Kodra e Trimave, www.prishtinapress.eu

Autoritetet kosovare kanë premtuar që furnizimi me energji elektrike në Kosovë do të stabilizohet pas ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re". Edhe debati mbi këtë temë tashmë ka shënuar dekadën e parë. Pritet që ndërtimi i termocentralit me kapacitet prodhimi prej 500 megavatësh energji elektrike në filloj në vitin 2019.

Doruntina HAJDINI

Mitrovica, qyteti me semaforë jashtë funksionit

Komuna premton se kjo çështje do të zgjidhet gjatë këtij viti. Për këtë janë ndarë mjete në vlerë 80 mijë euro.

Mitrovicë

Prej disa vitesh qyteti i Mitrovicës ballafaqohet me mungesë të dritave në semaforë. Semaforët kryesorë në qytet janë tërësisht jashtë funksionit. Ata janë të vendosur vetëm në tre pika brenda qytetit, por qytetarët kanë harruar se kur i kanë parë të ndezur për herën e fundit. Një gjendje e këtillë pa dyshim se rezulton të jetë mjaftë shqetësuese për banorët e Mitrovicës. Në masë të madhe ankohen ngasësit e automjeteve. Faton Sadiku, banor nga qyteti i Mitrovicës thotë se mungesa e semaforëve është problemi kryesor që Mitrovica e ka tash e disa vite.

"Vec mos me dalë me veturë hic në qytet se si po dalim po bllokohemi nga trafiku i veturave qe krijohet brenda qytetit, semaforët nuk po punojnë duhet të kemi shumë kujdes kur ngasim veturën se shumë lehtë mund të ndodhin aksidente", thotë ai. Edhe këmbësorët thonë se mungesa e semaforëve aktivë shume shpesh i rrezikon ata në qytet.

Labinot Sinani, banor i qytetit të Mitrovicës thekson se kalimi në semafor është shumë i rrezikshëm për aq kohë sa ata janë jashtë funksionojnë ata nuk punojnë.

"Po duhet me pasë shumë kujdes kur po e kalojmë rrugën se po vozitin shumë shpejt, ne prapë jemi më te rrituë edhe mundemi me rujtë veten po unë frikësohem për fëmijët sepse ka shumë fëmijë që shkojnë në shkollë e të cilët

Labinot Sinani, banor i Mitrovicës

janë të rrezikuar, sa herë që e kalojnë rrugën mund të godien nga një veturë", thotë ai.
Për këtë problem qytetarët fajësojnë Komunën e Mitrovicës.
"Këtu fajet i ka komuna se po investojnë pare nëpër gjëra të kota që nuk janë aq me rendesi për qytetin, e semaforët i kanë lënë mbas dore, nëpër shumë vende ku duhet me pasë semaforë aty nuk ka, edhe aty ku janë të vensodur nuk punojnë qe disa vite", u shpreh Bujar Osmani qytetar i Mitrovicës .Ai apelon tek Komuna e Mitrovicës për zgjidhjen e këtij problemi.
Drejtori për Sherbime Publike dhe Infrastrukturore ne Komunën e Mitrovices Naser Muja tha se për vitin 2019 është e paraparë vendosja e semaforëve të rinjë në tre pika të qytetit, "Semaforët aktualë kam dashtë me i aktivizu por janë jashtë sistemit sepse janë shumë të vjeter, diku te viteve 80-ta, mirëpo gjatë këtij viti do të largohen këta semaforë dhe do të zevendësohen me semaforë të rinjë", tha ai.
Ai bëri të ditur se Komuna e Mitrovicës fillimisht

Faton Sadiku, banor i Mitrovicës

Naser Muja, Drejtor për shërbime publike dhe infrastrukturë në komunën e Mitrovicës

nuk kishte dashur të ndante ansjë cent buxhet për rregullimin e semaforëve. "Kur e kam marrë këtë post, kam kërkuar nga komuna që të ndahet një buxhet për rregullimin e semaforëve, në fillim nuk ma aprovuan, por unë këmbëngula që rregullimi i semaforëve të jetë në rend te parë gjatë vitit 2019, pastaj është ndarë një shumë prej 80.000 euro për këtë projekt", tha Muja.
Policia e rajonit të Mitrovicës nuk ka mundur të thotë nëse mungesa e semaforëve ndikon në shtimin e numrit të aksidenteve. Në një përgjigje për këtë cështje Avni Zahiti, zëdhënës i policisë për këtë rajon, bën të ditur se gjithsejë 216 aksidente kanë ndodhur në vitin 2018 në Mitrovicë. Prej tyre 7 kanë qenë me lëndime trupore dhe të tjerat vetëm me dëme materiale; fatmirësisht asnjë nuk ka qenë me fatalitet.

Driton SADIKU

Qytetarët preferojnë produktet vendore

Në një intervistë për gazetën Astrit Panxha, drejtor ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve në Kosovë ka thënë se shitja e produkteve serbe në Kosovë ka shkaktuar konkurrencë të pabarabartë për shkak të cmimeve të ulëta

Tregu, Prishtinë

Kërkesa për blerjen e produkteve vendore është shtuar sidomos pas vënies së taksës 100 përqind në produktet e Bosnje e Herzovinës dhe Serbisë. Së fundi Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që marketet të identifikojnë origjinën e produktit duke i vendosur flamurin e shtetit nga vjen. Kështu edhe ata qytetarë që duan të konsumojnë produkte vendore e kanë më të lehtë t'i blejnë ato, duke i identifikuar me flamur. Prodhuesit vendor flasin për rritje të volumit të punës në shitje dhe prodhim pas masave të fundit të qeverisë ndaj produkteve serbe dhe boshnjake.

"Pas taksës 100 për qind, e cila ka qenë e domosdoshme, është bërë një rritje e madhe e konsumit të produkteve vendore. Po flas për rastin tonë, konsumi i produkteve është në rritje dhe prodhimi është në rritje me shumë i patateve", thotë Bedri Kosumi, pronar i kompanisë në një intervistë për gazetën.

Sa për qytetarët ata që e vizitojnë tregun e gjelbërt në kryeqytet, thonë se konsumojnë produkte vendore dhe se janë të kënaqur me cilësinë e tyre.

"Për mua është më e rëndësishme të konsumoj prodhimet vendore për shkak së janë më të shëndetshme dhe mendoj se duhet të konsumojmë vetëm produkte vendore mos të konsumojmë prodhime jasht vendit per shkak se rritet edhe Gjendja Ekonomike", thotë Akif Gashi nga Prishtina.

Por nga ana tjetër nuk mungojnë ankesat për rritje të çmimeve veçanërisht në prag të festave. "Jam konsumatore e tregut të gjelbërt por tash koha e dimrit po i rrisin çmimet për arsye të prodhimit vendor dhe festave te fund vitit", tha

Ajshe Berisha, banore e Prishtinës.
Në një intervistë për gazetën Astrit Panxha, drejtor ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve në Kosovë ka thënë se shitja e produkteve serbe në Kosovë ka shkaktuar konkurrencë të pabarabartë për shkak të çmimeve të ulëta. "Ne besojmë se taksa 100 për qind që i është aplikuar Serbisë është duke sjellë rezultate pozitive në aspektin e rritjes së prodhimit të produkteve në Kosovë. Duke pasur parasysh se kemi pasur konkurrencë jolojale nga produktet serbe që kanë ardhur në Kosovë dhe janë shitur nën kosto të prodhimit, atëherë rrjedhimisht me vënien e taksës 100 për qind, këto produkte më nuk janë konkurruese në Kosovë dhe nuk janë duke dëmtuar tregun. arsye, prodhuesit e Kosovës tash janë më konkurrent dhe disa prej tyre, nuk kemi të dhëna të sakta, më kanë informuar se krahas rritjes së prodhimit ka edhe rritje të punësimit", ka deklaruar Panxha.
Qeveria e Kosovës ka vendosur taksën 100 përqind për broduktet serbe dhe boshnjake në nëntor të vitit 2018.
Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se është detyruar ta marr këtë vendim për shkak të politikës jo korrekte të Serbisë ndaj Kosovës; vecanërisht në pjesën ku Serbia lobon për të tërhequr njohjet. Ndërsa kanë kaluar tre muaj nga hyrja në fuqi e masës, Serbia nga ana tjetër ka bllokuar procesin e dialogut me Kosovën. Një situatë e këtillë ka bërë që Bashkimi Europian

dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të kërkojnë nga qeveria Haradinaj të shfuqizoj vendimin që takson 100 përqind produktet serbe dhe boshnjake. Megjithë presionet Haradinaj në një takim të fundit, në shkurt 2019, me ambasadorin amerikan në Prishtinë, ka deklaruar se Kosova mbetet e vendosur në ruajtjen e miqësisë dhe përherë besnike ndaj aleatit strategjik, ShBA-së. "Marrëdhënia e ngushtë ndërmjet Kosovës dhe Amerikës është e pacenueshme, pa marrë parasyshë dallimin eventual në opinione", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e tij në facebook.

Venhar ISUFI

Festë e madhe artistike ndërkombëtare në Kolegjin AAB

Për herë të dytë u mbajt në Teatrin "Faruk Begolli" u mbajt Festivali tradicional Ndërkombëtar i Teatrove, i vetmi i këtij lloji në Kosovë, ku morën pjesë trupa teatrore nga Italia, Kroacia, Bullgaria, Kosova, Shqipëria etj.

Entuziazmi i jashtëzakonshëm dhe vullneti i madh mblodhi të gjithë dashamirësit e artit skenik dhe shumë spektatorë të tjerë që me padurim prisnin fillimin e javës së ekzaltimit skenik. Një rresht i madh ishte krijuar përpara portave të Teatrit të Kolegjit AAB, "Faruk Begolli". Jo, nuk ishte një javë e Noise Popit, festivalit të famshëm muzikor amerikan, por hapte siparin Festivali i Dytë Ndërkombëtar i Teatrove. Ishte java që tuboi trupa të famshëm teatrorë nga rajoni dhe Evropa: nga Italia, Kroacia, Shqipëria, Maqedonia, Bulgaria dhe Kosova.

Gratë duhet të shprehen

Ngjitësi i letrës sipër buzëve të tyre ishte elementi që rrëmbeu vëmendjen dhe zgjoi kureshtje tek publiku. Nëntë gra erdhën nga Maqedonia për të ndezur dritën e gjelbërt për gjitha gratë, se koha është që ato të jenë edhe më të pavarura. "Skena përherë të bën të ndihesh më mirë dhe më lehtë, të bën që zëri yt të jehojë dhe të dëgjohet", tha Drita Kaba – Karaga, aktore e kësaj shfaqeje. Perdja e kuqe u lëshua, për të vazhduar me vlerësimin e jurisë së studentëve dhe jurisë profesionale, që në dorë patën fatin e të gjithë garuesve deri në fund të edicionit artistik ndërkombëtar.

Lumturia e plotë e një fëmije është nëna

Shqiponja dykrenore fluturoi përsëri, por këtë herë për t'i treguar publikut diçka të re dhe të pazakontë. Shqipëria ishte konkurrenti i dytë i radhës që sfidonte veten me temën "Nëna dhe fëmija". Me një të folur të bukur dhe artistik dhe mesazhe të fuqishme, skena ngriti vetëdijen e audiencës së gjerë dhe preku ndjenjat e personave që e admirojnë artin. E në fund, pas duartrokitjeve të mëdha dhe brohoritjeve të fuqishme që morën, personazhi kryesor i shfaqjes, Ema Andrea, shtoi: "Ta duash nënën me dashuri të vërtetë jo vetëm me puthje, atëherë po jeton realitetin dhe jo iluzionin".

Shfaqja "Nena dhe femija"

Posteri zyrtar i PITF 2018

Të jesh i thjeshtë dhe pa komplekse, është sfidë e jo klishe

Gjysmë i zhveshur ishte paraqitja e tij skenike, ku me të vërtetë u rrëfye tek audienca dhe rrjedhshëm i transformoi ato në një dramë me ndikim të madh, tek të tjerët. Aktorin e vetëm nga Italia, që realizoi një monolog, të padëgjuar më parë, interpretoi lidhjet e tij të forta homoseksuale si një prift katolik, por tejet i sinqertë. "Të japësh diçka për tjetrin, kërkon emocion, por të marrësh dashuri dhe përkrahje nga audienca, të motivon të vazhdosh të jetosh", tha Alfredo Traversa, aktor dhe regjisor i shfaqjes, e cila shfaqje ka ngjallur debate edhe në Itali për shkak të thyrjes së disa tabuve kishtare.

Konferencë shtypi- Italy

Buzëqeshja, arma më e fuqishme për të mposhtur gjithçka

"Pula" ishte titulli i shfaqjes që interpretohej nga aktorët bullgarë. Një histori dashurie midis një çifti që paraqitën një lidhje të fuqishme dhe të pandashme. Një pulë në dorë, por jo të pjekur, një element gazmor e deri te rezultati i lirisë personale në art që sot ekziston.
"Kosova është një vend i bukur, jo vetëm nga ana fizike-gjeografike, por edhe nga ana shpirtërore", tha Vasil Duev, personazhi i "Pulës".

Shfaqja "Pula"

Konferencë shtypi- Bulgaria

Kroacia, vendi me mundësi realizimi për ëndrrat e tua

Më 3 dhjetor erdhën kroatët në Kolegjin AAB me një temë të titullar "Si nëna, si bija". "Drejtuesi i jetës tënde je vetëm ti dhe askush tjetër", ishin fjalët që aktorja Mirta Zeçeviq theksoi në konferencën e shtypit.

Komunikimi është metoda që zgjidh gjithçka

Shqipëria edhe njëherë kaloi tunelin dhe Rrugën e Kombit, për të sjellë në festival diçka tjetër, me personazhe të reja. Ishte shfaqja e gjashtë me radhë "Shërbëtoret", që karakteristikë kishte minutat e gjata. "Njeriu nuk duhet të keqpërdorë ato që Zotit i ka dhënë, por duhet t'i vlerësojë ato, sepse sot i ke të gjitha dhe nesër nuk të mbetet gjë", tha Laura Nezha, aktore e dramës.

Konferencë shtypi- Albania

Më mirë të jesh i pari në vendin tënd sesa i fundit në vend të huaj

Kosova erdhi me "Holly Shit", zhanri komedi, e cila ishte shfaqja e fundit për këtë edicion. Adrian Morina dhe Ylber Bardhi, ishin të vetmit personazhe të shfaqjes. Për adhuruesit e festivalit

risi ishte ndërrimi i roleve të shfaqjes në shumë pak minuta. “I kënaqur deri në pikën e fundit, lumturi më e madhe për mua ishte pjesëmarrja në festival” tha Ylber Bardhi.

Shfaqja “Holly Shit”

Ndarja e çmimeve në Edicionin e Dytë të Festivalit Ndërkombëtarë të Teatrove në Prishtinë

Me moton bindëse tash e dy vjet “Mos pyesni se çfarë mund të bëjë vendi juaj për ju, por pyesni se çfarë mund të bëni ju për vendin tuaj” thënie kjo e presidenti Kennedy që shënohej në broshurat e festivalit, u ndanë çmimet për garuesit në Edicionin e dytë të Festivalit Ndërkombëtar të Teatrove. Çmimet u ndanë për kategoritë: “Shfaqja më e mirë”, “Shfaqja më e mirë për media”, “Regjisori më i mirë” dhe “Aktori më i mirë”. Bullgaria mori dy çmime, për “Shfaqjen më të mirë” dhe “Regjisorin më të mirë”, ndërsa Maqedonia u vlerësua në kategorinë e “Aktorëve më të mirë”.

Kosova si shpërblim mori çmimet për: “Shfaqjen më të mirë”, “Shfaqjen më të mirë për media”, e në fund mori çmimin për “Aktorin më të mirë” të ndarë nga drejtori i Festivalit, Ilir Tafa dhe, drejtoresha artistike, Burbuqe Berisha.

Çmimet

Tafa vlerësoi lartë paraqitjet e trupave teatrore, por u shpreh edhe i lehtësuar pas organizimit të këtij festivali ndërkombëtar. “Preklëse, i erdhi fundi. Jam shumë i qetë me veten, që shqiptimi i fjalëve dhe gjuha reale e trupit po vazhdon të thurrë ndikim të madh, jo vetëm për artistët si ne, por edhe për njerëz të thjeshtë”.

Ceremonia e çmimeve

Për herë të fundit audienca u ngrit në këmbë dhe duartrokiti fort për të gjithë.

Temperaturat e ulëta nuk e larguan askënd për të shkuar në shtëpi. Trupat teatrore dhe publiku kremtuan deri në orët e vona të natës, duke e përmbyllur, kështu këtë rrugëtim njëjavor që tashmë është kthyer në traditë.

Edi SMAJLI

Qentë endacakë problem i vazhdueshëm për qytetarët

Bujar Zeqiri, veterinar në "Pet Center Prishtina" konfirmon se qentë endacakë mund të përcjellin sëmundje infektive.

Sulmi nga qentë endacakë vazhdon të jetë një problem që shqetëson edhe më tutje banorët në zona të ndryshme në Kosovë. Ard Demaku, 11 vjecar nga Hajvalia, tregon se u sulmua nga qentë endacakë derisa po kthehej nga shkolla.
"Ditën e premte un kam qenë duke u kthyer nga shkolla në ora 16:00, kur e kam pa që përballë meje po vinin disa qenë agresiv. njëri nga ta më ka sulmuar në krah në ato momente më ka ndihmuar një fqinj i imi", tregon 11 vjeçari.
Kjo ngjarje ka bërë që të gjithë banorët të frikësohen se mund të jenë viktima të radhës nga kafshimi qenëve.

Fëmija përballë qenve endacak në Hajvali

Prania e vazhdueshme e qenëve nëpër rrugë shkakton frikë dhe pasiguri tek qytetarët të cilët kërkojnë nga institucionet të ndërmarrin masa për parandalimin e ngjarjeve tragjike.
"Janë të rrezikshëm për shkak se aq sa e di une përcjellin edhe sëmundje ngjitëse kur nuk janë të vaksinuar", thotë Blend Islami, banor nga Prishtina
Shpesh qentë endacakë shfrytëzojnë si vend strehim shtëpi të pabanuara. Në lagjen Kodra e Trimave në Prishtinë është një e këtillë . " Bëhen shumë qenë këtu, edhe ne mbrëmje lehin më shumë si dhe i sulmojnë kalimtarët", tregon Bashkim Veseli, banor i lagjes. Ai shton se në rrezik ka qenë edhe bashkëshortja e tij duke i dërguar fëmijët në shkollë .

Kodra e Trimave

“Jemi kan edhe n’komunë ju kemi tregu cka osht tu na ndodh çdo dite edhe na kan than që jaë duke u marrë me ketë problem, po na s’po e shohim punen e tyne kerkund”, shprehet Veseli.

Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës

Bujar Zeqiri, veterinar në Pet Center Prishtina konfirmon se qentë endacakë mund të përcjellin sëmundje infektive.
“Numri i këtyre qenve është realisht i madh dhe shqetësues por pritet të rritet ende pasi që tani po afrohet stina e dimrit dhe ata çdoherë e më shumë ndjejnë mungesën e ushqimit. “Sëmundjet infektive të qenve endacakë dhe të pavaksinuar që mund të transmetohen te njeriu janë shumë të rrezikshme, sepse shpesh mund të shkaktojnë edhe vdekjen”, thotë ai.



Bujar Zeqiri, veterinar

Njëra nga këto sëmundje është tërbimi. Tërbimi është një sëmundje vdekjeprurëse, të cilën e mbartin qentë e infektuar(54%). Sëmundja bartet me anë të kafshimi edhe pse në disa raste bartja e virusit bëhet vetëm me kontaktin e pështymës së infektuar.



Prishtinë

Tetanozi është një tjetër sëmundje që mund të vijë nga mos aplikimi i serumit antitetanik brenda 24 orëve nga momenti i kafshimit. Kjo sëmundje paraqitet me shenja klinike të rënda që mund të çojnë deri në vdekje. Sëmundje të tjera infektive janë leishmania, gastroenteritis koronaviral i qenit(ÇV), infeksioni nga herpes virus, trakeobronkiti i qenve.

Prishtinë

Matrikulimi- trajtim i qenve nga veterinari

Por se cilat janë mënyrat e transmetimit të sëmundjes nga qeni tek njeriu, Zeqiri thotë se transmetimi nëpërmjet kafshimit nga kafsha e infektuar kur virusi gjendet në sekrecionet e pështymës, nëpërmjet ajrit kur sëmundja është me rrufë ose me kollë, transmetimi ndodh edhe kur prek qenin me lëkurë të infektuar.

Strehimorja e qenve në Lipjan

Prishtinë

Sipas tij sëmundjet infektive të këtyre kafshëve merren edhe nga qëndrimi afër fekaleve të qenve apo erës së tyre si dhe qëndrimi për një kohë të gjatë në të njëjtin ambient me ta. Se cila do ishte zgjidhja më e mirë veterinari Zeqiri rekomandon që qentë të dërgohen për trajtime shëndetësore, të vaksinohen, dhe më pas të strehohen në qendrat e strehimit. “E shoh të rrugës që pse jo këta qen të adaptohen më pas, për arsye që më nuk kanë ndonjë dallim nga qentë tjerë , vetëm se fati i tyre ka qenë që të jenë pa pronar”, thotë ai.

Fitore ZEQIRI

Jeta e vështirë e familjes Smakaj nga Skënderaj

Gjithsej 860 familje marrin ndihmë sociale nga komuna. Ky numër konsiderohet i madh për një komunë të vogël sic është Skënderaj; prandaj edhe kontributi i në ndihmë familjeve vec e vec është i vogël.

Skënderaj

Në fshatin Kllëdernicë të Komunës së Skënderajt jeton në kushte të vështira ekonomike familja pesë anëtarëshe Smakaj. Kryefamiljari Shabani tregon se familja e tij mbijeton falë ndihmës sociale prej 120 eurosh në muaj. "Unë nuk jam i aftë për punë, që nga koha që kam qenë I zënë rob në kohën e luftës nga forcat serbe" tregon ai. Cifti shabanaj kanë tre fëmijë, më e vogla është e moshës 1 vjec. Sigurimi i kushteve normale për jetë po bëhet cdo ditë e më i vështirë. Shtëpia në të cilën jeton kjo familje është e vjetëruar. Shaban Smakaj ankohet se autoritetet komunale kanë qendruar indifirent ndaj gjendjes sociale në të cilët ndodhet. Për këtë rast Osman Veliu, drejtor i drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Komunën e Skënderaj, thotë se komuna përpiqet t'i ndihmojë familjeve sipas nevojës dhe sipas radhës.

Numri i familjeve që marrin ndihmë sociale në komunën e Skenderajt është 860. Sipas tij, 860 familjet në asistencë kanë 3.969 anëtarë dhe marrin gjithsej 90.802.50 euro në muaj. Në mesin e tyre 822 familje janë shqiptare, 27 serbe, 3 rome, 2 ashkalikle, etj. Në kategorinë e parë janë 659 familje, ndërsa në kategorinë e dytë 197 familje.

Skënderaj

Në familjen Smakaj, Skënderaj.

"Shërbimi i asistencës sociale angazhohet për implementimin e plotë të ligjit pa dallim religjioni, gjinie e nacionaliteti. Janë verifikuar dhe riverifikuar lëndët sipas riaplikimit të familjeve që realizojnë të drejtën në asistencë sociale dhe është arritur rezultat pozitiv", ka siguruar Veliu.

Diarta MIFTARI

Fotoreportazh

Varfëria, papunësia dhe probleme të tjera kanë ndikuar që shumë fëmijë në Kosovë të përfshihen në tregun e punës.

(Foto e huazuar nga arkivi,kallxo.com)

Ata punojnë, kryesisht pastrues xhamash të automjeteve, shitës ambulantë, mbledhës mbeturinash të destinuara për riciklim etj. Rrugët e Prishtinës janë të mbushura me fëmijë që punojnë por edhe të tjerë që thjesht kërkojnë lëmoshë. Hulumtime të ndryshme kanë treguar se jo gjithmonë fëmijët ndodhen në të tilla pozicione me vullnetin e tyre. Ata shpesh janë viktima të rrjeteve kriminale.

Sheshi "Skënderbeu" Prishtinë, Foto: Gentiana Oraca

Prishtinë, foto e huazuar nga instagrami i D.Bunjaku

Fëmijët thonë se nganjëherë arrijnë të fitojnë 20 deri në 30 Euro.

(Foto e huazur nga arkivi time.al)

Koalicioni i OJQ-ve për mbrojtjen e fëmijeve: "Në Kosovë, referuar Agjencisë së Statistikave të Kosovës, përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjec të cilëët janë të angazhuar në punë, rezulton të jetë 10.7%, ndërkohë që 6.8 % e fëmijëve punojnë në kushte të rrezikshme.



Rruga "Garibaldi", afër Hotel Grandit, Foto: Gentiana Oraca

Sheshi "Nënë Tereze" Prishtinë, Foto: Gentiana Oraca



Prishtinë, Foto: Gentiana Oraca.

KOMF kërkon vëmendjen e kryetarëve të komunave për realizimin e detyrimeve qeverisëse, duke bërë që mbrojtja e fëmijëve të jetë prioritet në programet qeverisëse në nivel komunal, në mënyrë që të punohet në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda. Po kështu kërkohet trajtim i duhur në rritjen e shëndetshme të tyre dhe edukim të drejtë, larg çdo forme diskriminimi, abuzimi, trafikimi apo dukurie tjetër devijuese.

Alpinizmi në Malishevë

Në fillim asnjë grua nga Malisheva nuk i bashkohej grupit alpinist. Kjo edhe për faktin se ecja në natyrë me grupe të ndryshme njerëzish, konsiderohet si aktivitet i pafavorshem për gra në qytete të vogla si Malisheva. Me kalimin e viteve situata ka filluar të ndryshojë. Sot ka gra nga Kosova që kanë ngjitur madje edhe Everestin.

I mbyt kureshtja të dinë si kalonjë, si duken vendet, çfarë vizitojnë e si do të ishte një ditë në një aktivitet të tillë. Si mund t'i pershkruash me fjalë bukuritë e Alpeve Shqiptare, Gjiravicës, Valbonës, Kanjonit Matka e shumë vendeve të tjera.

Për shkak të rajoneve malore që ka, Kosova është bërë vend ideal për të zhvilluar alpinizmin. Këtë e kanë pohuar edhe udhëheqës të shoqatave të bjeshkatarëve në vend. Është thënë se bjeshkët më të mira në Kosovë që duhet patjetër të vizitohen janë ato të Rugovës dhe Malet e Sharrit.

Burim Buzhala dhe Shqipdon Shurdhaj nga Komuna e Malishevës kanë hapur një klub me qëllim që qytetarët të aktivizohen në natyrë dhe alpinizëm.

Misioni i këtij klubi është ta njoftojë dhe ta ofrojë shoqërinë më shumë me natyrën në Kosovë e për të vazhduar edhe në vende të tjera.

Klubi Alpin – Bjeshkatar "Malisheva" u krijua në vitin 2015.

"Fillimi ishte i veshtirë, pasiqë qytetarët nuk ishin të informuar për këtë klub. Por, aktiviteti i parë që bëri që ne të vazhdojmë të merreshim ende me organizime, ishte në vitin 2017", tha Burim Buzhala, kryetar i klubit.

Edhe pse kishin dy vite qe po merreshin dhe punonin qe t'i informonin qytetarët për natyrën dhe aktivitetet, në Komunen e Malishevës interesimi ishte shumë i vogël. Meshkujt ishin më shumë të interesuar, ndërsa femrat nuk ishin të informuara për klubin dhe organizimet e kësaj natyre.

"Pjesëmarrja ishte e vogël në fillim dhe në të gjitha aktivitete kanë qenë vetëm meshkuj, jo se ne kemi vendosur, por nuk ka pasur femra të interesuara për të marrë pjesë në to", bëri të ditur kryetari i klubit.

Në gjithsej 13 aktivitete të organizuara nga klubi, asnjë grua nuk kishte marrë pjesë. Kjo edhe për faktin se në disa raste familja nuk i kishte lejuar.

"Mua më pëlqen shumë te marr pjesë dhe jam e informuar për këto aktivitete, sepse kam shoqe qe marrin pjesë dhe me tregojne sa bukur është e si kalojnë. Por, unë s'mund të shkoj sepse familja s'ma lejon", tha B.Sh 23 vjeçare nga Komuna e Malishevës.

Ky klub ndoshta nuk mund të ofrojë shumë, por mund t'i ofrojë njerëzit me natyrën në Kosovë dhe të shteteve në rajon, e po kështu edhe të

ndikojë pozitivisht në shëndet. Përkundër disa rasteve ku vajzat deklarohen se nuk bëjnë alpinizëm për shkak të familjes, ka të tilla që tashmë e kanë shndërruar në rutinë ecjen dhe ngjitjen në natyrë. Ato tregojnë për anët pozitive të këtyre aktiviteteve.

"Është e dyta herë që marr pjesë në këto aktivitete. Është jashtëzakonisht bukur. Natyra të qetëson, ashtu edhe kur je i rrethuar me këta të rinj që me këtë disponim, energji e të qeshura, te bëjnë t'i harrosh edhe vitet e tua", tha një 45-vjeçare nga Malisheva që i ishte bashkuar grupit.

Ndonëse në zona rurale aktivitetet sportive dhe alpinizmi nuk pëlqehen edhe aq shumë nga gratë dhe vajzat, janë pikërisht ato të cilat në vitet e fundit kanë pushtuar majat më të larta duke shënuar kështu kthesën e madhe për rëndësinë e barazisë gjinore edhe në këto aktivitete.

Flutura Ibrahimi, e njohur për të gjithë si Uta Ibrahimi, është shqiptarja e parë që është ngjitur në Everest në vitin 2017. Ajo është ngjitur edhe në Lhoste- mali i katërt më i lartë në botë në vitin 2018, si pjesë e qëllimeve të saj për t'u ngjitur në 14 majat më të larta në botë në shtatë vite.

Majën më të lartë të botës, Everestin, e ka arritur edhe Arineta Mula, alpiniste nga Peja e cila në komentet e saj i kushton hapësirë të konsiderueshme maleve të Kosovës.

Për shkak të rajoneve malore që ka, Kosova është bërë vend ideal për të zhvilluar alpinizmin. Këtë e kanë pohuar edhe udhëheqës të shoqatave të bjeshkatarëve në vend. Është thënë se bjeshkët më të mira në Kosovë që duhet patjetër të vizitohen janë ato të Rugovës dhe Malet e Sharrit.

"Udhëtimi im i bukur nëpër male ka filluar në vendin tim, Kosovën. Nuk mund ta fsheh fare: U dashurova në vendin tim, në kulturën, traditën, në natyrën tonë mahnitëse dhe mbi të gjitha u dashurova në njerëzit që takova rrugës dhe që me ndihmuan të besoj në të mirën! Me ta kam ndërtuar ngadalë rrugën e dashurisë, forcës dhe guximit të vërtetë. Kjo më ka ndryshuar mënyrën se si mendoj e si jetoj. Tash e gjithmonë dua ta kaloj jetën sa më afër natyrës", kështu ka shkruar Arineta Mula, në blogun e saj.

"Besoj që gratë mund të bëjnë më shumë se që mendojmë që mundemi", ka deklaruar ajo së fundi në një intervistë për televizionin britanik BBC.

Bjeshkët e Sharrit

Në disa raste pjesë të organizimeve bëhen edhe fëmijët. Eldari, 8-vjeçar, kënaqej shumë me gjithçka që ofronte natyra. Çdo gjë që shihte e bënte, emocionohej. Diçka të re që nuk e kishte parë më herët, rrjedhimisht kishte shumë pyetje.

Eldari nuk ecte por vraponte dhe nuk lodhej fare sepse dëshira e tij ishte të shihte shumë me shumë. Ai dëshironte edhe foto ne secilin vend vend e me të gjithe qe t'ju tregonte shokëve se si ka kaluar e në cfarë vendi ka qenë, fliste me me buzëqeshje e aq dashuri dhe pyeste: "Unë prapë do te vij, a do të më merrni?".

Besmire GAJRAKU

Panairi “Blej Shqip” mirëpritet nga konsumatorët

Për dallim nga shitësit të cilët konsiderojnë që numri i blerësve është drejt rënies, qytetarët shprehen se janë të kënaqur me çmimet promovuese në panair.

Për të tretin vit radhazi Komuna e Prishtinës ka organizuar panairin “Blej Shqip” me rastin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit dhe Pavarësisë së Shqipërisë. Sheshi “Nënë Tereza” në Prishtinë, bëri bashkë rreth njëqind biznese nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia.

Eleonor Rexhepagiq nga Ulqini, mori pjesë për herë të parë në këtë panair.

“Unë kam te ekspozuar kryesisht sapunë me vaj ulliri, kanellë dhe rozmarinë. Këta janë sapunë bio (natyral), pa ngjyrë dhe pa kimikale te rrejshme’’, tregon Rexhepagiq. Ajo shprehet se perkundër motit jo të mirë, produktet e saj po shiten mirë dhe nëse do të ftohet në panairet e radhës ajo nuk do të hezitoj të vijë sërish.

Nga ana tjetër, Xheva Mustafa, pjesëmarrëse e rregullt e panairit nuk është e kënaqur nga shitja e produkteve. Ajo në një tendë të vogël promovon punime dore.

‘’Çmimet nuk janë shumë të larta, por interesimi i qytetarëve është më i dobët se i viteve të kaluara, ndoshta sepse ka shumë zgjidhje’’, thotë ajo. Sa për qytetarët, ata janë të kënaqur me çmimin e produkteve ushqimore. Disa prej tyre e vizituan panairin për herë të parë.

‘’Unë më shumë jam i interesuar për gjëra ushqimore, por çmimet e mira, nuk qenkan keq’’, u shpreh Hasani nga Prishtina. Në panairin’’ Blej Shqip’’ mes te tjerash ekspozohen edhe produkte të tjera si mjalti, turshitë, veshëmbadhje me motive folklori dhe kombëtare e shumë gjëra te tjera.

Ky panair është organizuar nga Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqiperisë. Qëllimi i tij është që të bëhet sensibilizimi i qytetarëve që të konsumojnë produkte vendore nga Kosova dhe Shqipëria por edhe nga vende të tjera në rajon ku jetojnë shqiptarët.

Bledë KRASNIQI Elhame SALIHU